FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 166

Tiranë – E mërkurë, 14 dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 766, datë 12.12.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 528, datë 24.6.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën 1/1 të re për zhvillim, në Njësinë Administrative Thumanë, Bashkia Krujë".....	19369
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 767, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 1134, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Tiranë dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese", të ndryshuar.....	19373
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 768, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 201, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkitë Durrës dhe Kamzë", të ndryshuar.....	19373
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 769, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 1145, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objektit arsimor shkolla 9-vjeçare 'Hajdar Zogu', fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatuese".....	19374
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 770, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 613, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Durrës".....	19374
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 771, datë 12.12.2022	Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 215, datë 31.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale, në bashkitë Lezhë dhe Kurbin dhe caktimin e tyre si njësi zbatuese".....	19375

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 27, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë dhe Kurbin".....	19376
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 773 , datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 715, datë 24.11.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit e të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë".....	19376
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 774, datë 12.12.2022	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr. 71, datë 3.2.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare 'Vëllezërit Masha', Mazhë e Vogël, Njësia Administrative Bubq, Bashkia Krujë, dhe caktimin e bashkisë Krujë si njësi zbatuese".....	19377
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 12.12.2022	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr. 122, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të shkollës 9-vjeçare 'Picar', Bashkia Vorë, dhe caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese".....	19377
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 166, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kamzë dhe caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese".....	19378
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 167, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë, Kamzë dhe Rrogozhinë".....	19378
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 778, datë 12.12.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 181, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë".....	19379
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 779, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 279, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak, dhe caktimin e Bashkisë Shijak si njësi zbatuese", të ndryshuar.....	19380
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 12.12.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 503, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak".....	19380
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 12.12.2022	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit, në Bashkinë Tiranë.....	19381
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 12.12.2022	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit/riparimit të njësive individuale të banimit/njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Tiranë.....	19381

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 783, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 200, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Mirditë e Kamzë dhe caktimin e tyre si njësi zbatuese", të ndryshuar.....	19382
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 12.12.2022	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr. 236, datë 14.4.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të godinës së kopshtit publik dhe të godinës së Bashkisë Vorë, Bashkia Vorë, dhe caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese".....	19382
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 785, datë 12.12.2022	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr. 238, datë 14.4.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të 3 (tri) objekteve në Bashkinë Mirditë dhe caktimin e Bashkisë Mirditë si njësi zbatuese".....	19383
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 412, datë 15.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale, në bashkitë Kamzë dhe Lezhë".	19384
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike, në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona '5 Maji', dhe Njësinë Administrative 6, zona 'Kombinat', Bashkia Tiranë", të ndryshuar.....	19384
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 428, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Kurbin dhe caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese".....	19385
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 12.12.2022	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr. 770, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare 'Demokracia', Valias i Ri, Bashkia Kamzë, dhe caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese".....	19385
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 790, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 1034, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për riforcimin e pallatit të kulturës 'Dedë Ndue Lazri', në Bashkinë Lezhë".....	19386
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 791, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 910, datë 18.11.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të konviktit të shkollës së mesme profesionale 'Kolin Gjoka', Bashkia Lezhë dhe caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese".....	19386
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 792, datë 12.12.2022	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr. 151, datë 10.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të çerdhes 'Valias', në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, dhe caktimin e bashkisë Kamzë si njësi zbatuese".....	19387

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 12.12.2022	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr. 26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Kamzë dhe Kavajë dhe caktimin e tyre si njësi zbatuese", të ndryshuar.....	19387
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 794 datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 145, datë 11.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë"	19388
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 795, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 90, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit të godinës kopsht/çerdhe në zonën e re për zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, dhe caktimin e Bashkisë Mirditë si njësi zbatuese".....	19388
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 89, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të godinave, spitali 'Shenjta Mari' dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-Spitali Infektiv), Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, dhe caktimin e Bashkisë Mirditë si njësi zbatuese.....	19389
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 797, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 935, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe banesave individuale, në bashkitë Durrës dhe Lezhë", të ndryshuar.....	19389
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 68, datë 3.2.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit dhe të rikonstruksionit të bibliotekës 'Gjergj Fishta' dhe caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese"".....	19390
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 800, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 749, datë 9.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit dhe caktimin e Institutit të Ndërtimit si njësi zbatuese".....	19390
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 801, datë 12.12.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave", të ndryshuar.....	19391
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 802, datë 12.12.2022	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit dhe rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detyruar", të ndryshuar.....	19391

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 12.12.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 441, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projekteve për miratimin e lejeve të ndërtimit për ndërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Mirditë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak dhe Vorë", të ndryshuar.....	19392
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 804, datë 12.12.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar", të ndryshuar.....	19393
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 806, datë 12.12.2022	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Mat të pronës nr. 717, me emërtim "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në Burrel, zona kadastrale 1326, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, dhe vendimin nr. 771, datë 14.11.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Burrel, të qarkut të Dibrës".....	19393
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 12.12.2022	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës me emërtim "Agjencia Lundër", me vendndodhje në Lundër, Tiranë, zona kadastrale 2529, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit)", të ndryshuar.....	19395
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 12.12.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar.....	19397
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 810, datë 12.12.2022	Për disa shtesa në vendimin nr. 646, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave e të kritereve të përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik", të ndryshuar.....	19397
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 813, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 606, datë 14.9.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e programit kombëtar për aktivitetet jashtë orarit mësimor dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit".....	19398
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 21, datë 9.12.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 11.2.2022, "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të ndryshuar.....	19399

VENDIM
Nr. 766, datë 12.12.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 528, DATË 24.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË ZONËN 1/1 TË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", dhe të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 6.1.2020, "Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit", të ndryshuar, nr. 8, datë 6.1.2020, "Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje", të ndryshuar, e nr. 44, datë 22.1.2020, "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si njësi zbatuese", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 528, datë 24.6.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikat 3 dhe 4, shifra "… 20 932 039 (njëzet milionë e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e tridhjetë e nëntë) lekë …" zëvendësohet me "… 20 611 147 (njëzet milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e shtatë) lekë ...".

b) Në tabelën bashkëlidhur vendimit bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. nënndarjet me numrat rendorë 18 dhe 22, që i përkasin pasurive me nr. 122/2, zonë kadastrale 3599, me vlerë kompensimi 3 978 000 (tre milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë dhe nr. 51/15, zona kadastrale 3599, shfuqizohen;

ii. të dhënat për pasuritë nr. 25/1, nr. 53/6, nr. 53/3 dhe nr. 53/1, që i përkasin, përkatësisht, nënndarjeve me numrat rendorë 6, 11, 14 dhe 16, ndryshohen sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iii. shtohen nënndarjet me numrat rendorë 27, 28, 29 dhe 30, që i përkasin, përkatësisht, pasurive nr. 51/12, nr. 51/14, nr. 51/32 dhe nr. 51/33, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale të këtij vendimi, në vlerën prej 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Efekti financiar sipas pikës 1, të këtij vendimi, të zbritet nga fondi i akorduar për Bashkinë Krujë për këtë projekt, por të pashpenzuar dhe të mbartur në buxhetin e vitit 2022, dhe të kthehet në zërin "Fondi i rindërtimit", të miratuar në buxhetin e vitit 2022.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Krujë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT PËR SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 528, DATË 24.6.2020, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË ZONËN 1/1 TË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE THUMANË,

BASHKIA KRUJË"

Nr. rendor	Seksioni A që pasqyron pasurinë që ndryshohet në tabelën bashkëlidhur VKM nr. 528 datë 24.6.2020															Shënime
	Nr. rendor sipas VKM nr. 528 datë 24.6.2020	STATUSI JURIDIK								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM, SIPAS LLOJIT TË PASURISË			Vegjetacion	Dokumenti i pronësisë	Kompensim	VLERA TOTALE (lekë)	
		PRIVAT			SHTET	TË DHËNAT (mbi pasurinë, sipas ASHK - Krujë)				Shpronësim tokë "arë"	Çmimi lekë/m²	Vlera /lekë					
		Emri	Atësi	Mbiemër		ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale m²								
6	6	ZOJE AFRIM SARA	KURT XHEMALI XHEMALI	ZIRA ZIRA ZIRA		3599 THUMANË	25/1	ARË	4,100.0	4,100.00	442	1,812,200.0		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	**1,812,200**	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 528, datë 24.6.2020 me nr. rendor 6, me status juridik të pronësisë 'shtet', e llojit 'arë', me sipërfaqe 4100 m², me vlerë totale të shpronësimit 0 lekë. Pas daljes së VKM nr. 528 datë 24.6.2020, është regjistruar AMTP më datë 28.1.2021 dhe statusi juridik i kësaj pasurie është bërë 'privat'. Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Krujë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2, datë 24.9.2021, kjo pasuri është e llojit 'arë' dhe është certifikuar me sipërfaqe 4100 m².
11	11	SABA	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	53/6	ARË	1,750.00	1,750.00	442	773,500.0		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	**773,500**	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 528 datë 24.6.2020 me nr. rendor 11, me status juridik të pronësisë 'privat', e llojit 'arë', me sipërfaqe për shpronësim 2300 m² dhe vlerë totale të shpronësimit 1,016,600 lekë. Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Krujë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2, datë 24.9.2021, kjo pasuri është e llojit 'arë' dhe është certifikuar me sipërfaqe 1750 m².
14	14	NAFIJE ALMA EGLANTINA TEUTA ALFRED SONILA KLEVIS	SALI ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL	ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA		3599 THUMANË	53/3	ARË	1,750.00	1,750.00	442	773,500.0		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	**773,500**	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 528, datë 24.6.2020 me nr. rendor 14, me status juridik të pronësisë 'privat', e llojit 'arë', me sipërfaqe për shpronësim 2040 m² dhe vlerë totale të shpronësimit 901,680 lekë. Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Krujë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2 datë 24.9.2021, kjo pasuri është e llojit 'arë' dhe është certifikuar me sipërfaqe 1750 m2.
16	16	FATIME FLORA GEZIM MIMOZA FATMIRA ARJANA GAZMIR	SALI SINAN SINAN SINAN SINAN SINAN SINAN	QIRA CARUNGU QIRA KURTI KURTI RRYCI QIRA		3599 THUMANË	53/1	ARË	5,350.00	5,350.00	442	2,364,700.0		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	**2,364,700**	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 528 datë 24.6.2020 me nr. rendor 16, me status juridik të pronësisë 'privat', e llojit 'arë', në pronësi të Mereme Tare Zira, me sipërfaqe për shpronësim 5620 m² dhe vlerë totale të shpronësimit 2,484,040 leke. Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Krujë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në

																FSHZH me nr. 1768/2 datë 24.9.2021, kjo pasuri është e llojit 'arë' dhe është certifikuar me sipërfaqe 5350 m^2 në pronësi të trashëgimtarëve ligjorë të Mereme Tare Zira.
Seksioni B që pasqyron pasurinë që shtohet në tabelën bashkëlidhur VKM nr. 528, datë 24.6.2020																
27		ASTRIT	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	51/12	ARË	1,150	**180.20**	**442**	**79,648.4**		**Kartela e Pasurisë së Paluajtshme**	√	**79,648.40**	Nr. dok. 01007, data e regjistrimit 29.1.2019, tipi ND, mbi këtë ndodhet ndërtesa me nr. 51/30, vol. 9, f. 50 . Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Krujë me shkresën nr. 434/1 datë 17.3.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 208/3, datë 18.3.2021, kjo pasuri përfshihet në sitin e rindërtimit. Kjo pasuri është certifikuar më datë 18.8.2020 pas daljes së VKM nr. 528, datë 24.6.2020 Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Krujë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2 datë 24.9.2021, kjo pasuri është e llojit 'arë' dhe është certifikuar me sipërfaqe 1150 m^2.
28		ASTRIT	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	51/14	ARË	3,300	**1,110.50**	**442**	**490,841.0**		**Kartela e Pasurisë së Paluajtshme**	√	**490,841.00**	Nr. dok. 0878, data e regjistrimit 16. 2.2017, tipi ND, Mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa me nr. 51/26 vol.8, f. 206 Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Krujë me shkresën nr. 434/1 datë 17.3.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 208/3 datë 18.3.2021, kjo pasuri përfshihet në sitin e rindërtimit. Kjo pasuri është certifikuar më datë 18.8.2020 pas daljes së VKM nr. 528, datë 24.6.2020 Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Krujë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2, datë 24.9.2021, kjo pasuri është e llojit 'arë' dhe është certifikuar me sipërfaqe 3300 m^2.
29		PASHE ARBEN ILIR MIRELA DEJE	MUHAREM VATH VATH VATH VATH	UKA UKA UKA ÇERA (UKA) UKA		3599 THUMANË	51/32	ARË	2,010.00	**1,725.30**	**442.0**	**762,582.6**		**Kartela e Pasurisë së Paluajtshme**	√	**762,582.60**	Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Krujë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2, datë 24.9.2021, pasuria nr. 51/32 ka rezultuar pas mbylljes së pasurisë nr. 51/15, vol. 4, f. 187 dhe regjistrimit të AMTP. Me VKM nr. 528, datë 24.6.2020 pasuria nr. 15/15 është shpronësuar me status juridik të pronësisë 'shtet', me sipërfaqe 32350 m^2. Pas daljes së VKM nr. 528 datë 24.6.2020, është regjistruar AMTP më datë 2.7.2020 dhe është hapur pasuria nr. 15/32 me statusin juridik 'privat'. Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Krujë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2, datë 24.9.2021, kjo pasuri është e llojit 'arë' dhe është certifikuar me sipërfaqe 2010 m^2.
30		PASHE ARBEN ILIR MIRELA DEJE	MUHAREM VATH VATH VATH VATH	UKA UKA UKA ÇERA (UKA) UKA		3599 THUMANË	51/33	ARË	2,490.00	**2,268.00**	**442.0**	**1,002,456.0**		**Kartela e Pasurisë së Paluajtshme**	√	**1,002,456.00**	Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Krujë me shkresën nr. 1761/1 datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2 datë 24.9.2021, pasuria nr. 51/33 ka rezultuar pas mbylljes së pasurisë nr. 51/15 vol. 4, f. 187 dhe regjistrimit të AMTP. Me VKM nr. 528, datë 24.6.2020 pasuria nr. 15/15 është shpronësuar me status juridik të pronësisë 'shtet', me sipërfaqe 32350 m^2. Pas daljes së VKM nr. 528 datë

																24.6.2020, është regjistruar AMTP me datë 2.7.2020 dhe është hapur pasuria nr. 15/33 me status juridik 'privat'. Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Krujë me shkresën nr. 1761/1, datë 24.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 1768/2, datë 24.9.2021, kjo pasuri është e llojit 'arë' dhe është certifikuar me sipërfaqe 2490 m2.
	VLERA TOTALE (LEKË)														**8,059,428.00**	

1. Çmimi sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Z. K.	**Çmimi (lek/m²)**	
2182	truall	322
	arë	362
3599	truall	442
	arë	442

VENDIM
Nr. 767, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1134, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/ RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE, NË BASHKINË TIRANË DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 1134, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 760 634 149 (shtatëqind e gjashtëdhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e njëqind e dyzet e nëntë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore (RSU nr. 1 (nr. 15–18–19) nr. 20–21; nr. 22–23", në RSU nr. 1 shkolla "Dritas", në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar, përkatësisht, sipas detajimit të mëposhtëm, për:

a) ndërtimin e godinës tip në RSU nr. 1 (nr. 15), në vlerën 106 099 202 (njëqind e gjashtë milionë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dy) lekë pa TVSH;

b) ndërtimin e godinës tip në RSU nr. 1 (nr. 19), në vlerën 10 207 472 (dhjetë milionë e dyqind e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH;

c) ndërtimin e godinës tip në RSU nr. 1 (nr. 18), në vlerën 236 807 314 (dyqind e tridhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e shtatë mijë e treqind e katërmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

ç) rikonstruksionin e godinave nr. 20–21, nr. 22–23, në vlerën 277 522 999 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e njëzet e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH;

d) ndërtimin e shkollës 9-vjeçare "Dritas", në vlerën 129 997 161 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 768, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 201, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) NË BASHKITË DURRËS DHE KAMZË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 201, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2 Përveç përcaktimeve të pikës 2/1, të këtij vendimi, përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 568 048 796 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, nga Bashkia Durrës, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 769, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1145, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT ARSIMOR SHKOLLA 9-VJEÇARE 'HAJDAR ZOGU', FSHATI TAPIZË, NJËSIA ADMINISTRATIVE NIKËL, BASHKIA KRUJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KRUJË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 1145, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, për financimin e rindërtimit të objektit arsimor, shkolla 9-vjeçare "Hajdar Zogu", fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë, të jetë në vlerën 82 365 162 (tetëdhjetë e dy milionë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 770, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 613, DATË 20.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË DURRËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e

Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 613, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 449 129 166 (katërqind e dyzet e nëntë milionë e njëqind e njëzet e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në Bashkinë Durrës, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Durrës, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 771, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 215, DATË 31.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË LEZHË DHE KURBIN DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 215, datë 31.3.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi, i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 55 850 000 (pesëdhjetë e pesë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, në Bashkinë Kurbin, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Kurbin, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 772, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 27, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË DHE KURBIN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës, të vendimit nr. 27, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 592 639 074 (pesëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bashkitë Tiranë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi, në masën 387 370 974 (treqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e treqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 205 268 100 (dyqind e pesë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind) lekë, pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kurbin e Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 773, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 715, DATË 24.11.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT E TË RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS DHE MIRDITË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 715, datë 24.11.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, në masën 458 142 074 (katërqind e pesëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dyzet e dy mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa

(pallat), në bashkitë Durrës dhe Mirditë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 310 546 268 (treqind e dhjetë milionë e pesëqind e dyzet e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi, në masën 147 595 806 (njëqind e dyzet e shtatë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës dhe Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 774, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 71, DATË 3.2.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE 'VËLLEZËRIT MASHA', MAZHË E VOGËL, NJËSIA ADMINISTRATIVE BUBQ, BASHKIA KRUJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KRUJË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 71, datë 3.2.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Krujë, për vitin 2022, i transferohet fondi, në masën 58 204 175 (pesëdhjetë e tetë milionë e dyqind e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "Vëllezërit Masha", Mazhë e Vogël, njësia administrative Bubq, Bashkia Krujë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.";

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 775, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 122, DATË 2.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE 'PICAR', BASHKIA VORË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.

115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 122, datë 2.3.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, edhe në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të shkollës 9-vjeçare "Picar", Bashkia Vorë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2 dhe 2.1 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 776, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 166, DATË 18.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË KAMZË DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 166, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përveç përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi, përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, nga Bashkia Kamzë, në masën 110 000 000 (njëqind e dhjetë milionë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, i cili i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 777, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 167, DATË 18.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, VORË, KAMZË DHE RROGOZHINË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit

dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 167, datë 18.3.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 183 228 700 (njëqind e tetëdhjetë e tre milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Vorë dhe Kamzë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Vorë i transferohet fondi, në masën 147 788 700 (njëqind e dyzet e shtatë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 35 440 000 (tridhjetë e pesë milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Vorë e Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 778, datë 12.12.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 181, DATË 30.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS, SHIJAK, LEZHË DHE KRUJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 181, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përveç përcaktimeve të bëra në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 2, të këtij vendimi, përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, për bashkitë Durrës dhe Shijak, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 50 812 754 (pesëdhjetë milionë e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 24 503 046 (njëzet e katër milionë e pesëqind e tre mijë e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Në pikën 3, pas fjalëve "... sipas pikave 1 e 2, ..." shtohen "... dhe 2/1 ...".

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Shijak dhe Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 779, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 279, DATË 12.5.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT SOCIAL-KULTUROR, PALLATI I KULTURËS, BASHKIA SHIJAK, DHE CAKTIMIN E BASHKISË SHIJAK SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ligji nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 279, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Bashkisë Shijak, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, nga fondet e rindërtimit, miratuar për vitin 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar në masën 1 536 000 (një milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit dhe ndërtimit të infrastrukturës publike, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 780, datë 12.12.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 503, DATË 27.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, VORË DHE SHIJAK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 503, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 shfuqizohet.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Efekti financiar për bashkitë Vorë dhe Shijak, sipas shkronjave "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi i rindërtimit i miratuar për vitin 2022 dhe i transferohet bashkive Vorë dhe Shijak në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Vorë dhe Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 781, datë 12.12.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT, NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 851 358 017 (një miliard e tetëqind e pesëdhjetë e një milionë e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëmbëdhjetë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, që rezultojnë me shkallë dëmtueshmërie DS5, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në Bashkinë Tiranë.

2. Përdorimi i fondit, i miratuar për vitin 2022, është në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, që rezultojnë me shkallë dëmtueshmërie DS5, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 782, datë 12.12.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT/RIPARIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT/ NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 136 815 424 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e katër) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose riparimit të njësive individuale të banimit/njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, që rezultojnë me shkallë dëmtueshmërie DS4 dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime në Bashkinë Tiranë.

2. Përdorimi i fondit, miratuar për vitin 2022, në masën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, i transferohet Bashkisë Tiranë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit ose riparimit të njësive individuale të banimit/njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, që rezultojnë me shkallë dëmtueshmërie DS4 dhe që nuk duhen rindërtuar

nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime në Bashkinë Tiranë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 783, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 200, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKITË MIRDITË E KAMZË DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/2, të vendimit nr. 200, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

"2/3. Përveç përcaktimeve të pikës 2/2, të këtij vendimi, përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 29 438 505 (njëzet e nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Mirditë, të detajuar, si më poshtë vijon:

a) Rikonstruksion dhe sistem ngrohjeje i godinës nr. 3 (3 kate), shkolla 9-vjeçare "Pashko Vasa", Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 14 859 730 (katërmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH, në formën transfertës së pakushtëzuar;

b) Rikonstruksioni i kopshtit të fëmijëve (godina e vjetër) Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 4 216 892 (katër milionë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, në formën transfertës së pakushtëzuar;

c) Rikonstruksioni i kopshtit të fëmijëve me aftësi ndryshe (ish-godina e SHIK-ut) Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 10 361 883 (dhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, në formën transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 784, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 236, DATË 14.4.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË GODINËS SË KOPSHTIT PUBLIK DHE TË GODINËS SË BASHKISË VORË, BASHKIA VORË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të

ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 236, datë 14.4.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Vorë, për vitin 2022, i transferohet fondi, në masën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të godinës së kopshtit publik, Bashkia Vorë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 785, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 238, DATË 14.4.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË 3 (TRI) OBJEKTEVE NË BASHKINË MIRDITË DHE CAKTIMIN E BASHKISË MIRDITË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar. me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 238, datë 14.4.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Mirditë, për vitin 2022, i transferohet fondi në masën 83 451 289 (tetëdhjetë e tre milionë e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të 3 (tri) objekteve në Bashkinë Mirditë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, të detajuara, si më poshtë vijon:

a) Rikonstruksionin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve Mirditë (ish-kinemaja), në masën 22 108 052 (njëzet e dy milionë e njëqind e tetë mijë e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH;

b) Rikonstruksionin e ish-godinës së Bashkisë Mirditë, në masën 41 655 628 (dyzet e një milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë) lekë pa TVSH;

c) Rikonstruksionin e godinës së Muzeut Historik Mirditë, në masën 19 687 609 (nëntëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntë) lekë pa TVSH.

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohen me "... 1, 2 dhe 2.1...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 786, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 412, DATË 15.6.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË KAMZË DHE LEZHË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 412, datë 15.6.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, nga Bashkia Kamzë, edhe në masën 34 000 000 (tridhjetë e katër milionë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, sipas aktekspertizave të thelluara, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 787, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 645, DATË 3.8.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) DHE NDËRTESAVE PUBLIKE, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NË NJËSITË ADMINISTRATIVE 4 E 8, ZONA '5 MAJI', DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE 6, ZONA 'KOMBINAT', BASHKIA TIRANË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.1, të vendimit nr. 645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.2, me këtë përmbajtje:

"2.2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 3 300 234 940 (tre miliardë e treqind milionë e dyqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e dyzet) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona "5 Maji", dhe njësinë administrative 6, zona "Kombinat" në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 788, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 428, DATË 8.7.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE, NË BASHKINË KURBIN DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i", dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 428, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Kurbin, për vitin 2022, i transferohet fondi, në masën 30 580 000 (tridhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kurbin, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Milot, Bashkia Kurbin, në masën 9 174 000 (nëntë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH;

b) Rikonstruksion i shkollës së mesme "Milot", Bashkia Kurbin, në masën 21 406 000 (njëzet e një milionë e katërqind e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 789, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 770, DATË 15.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE 'DEMOKRACIA', VALIAS I RI, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 770, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 101 000 000 (njëqind e

një milionë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamzë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.";

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2 …" zëvendësohen me "… sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 …".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 790, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1034, DATË 16.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR RIFORCIMIN E PALLATIT TË KULTURËS 'DEDË NDUE LAZRI', NË BASHKINË LEZHË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3, të vendimit nr. 1034, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 104 000 000 (njëqind e katër milionë) lekë pa TVSH, për riforcimin e pallatit të kulturës "Dedë Ndue Lazri", Bashkia Lezhë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Lezhë, në formën e transfertës të pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 791, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 910, DATË 18.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË KONVIKTIT TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE 'KOLIN GJOKA', BASHKIA LEZHË DHE CAKTIMIN E BASHKISË LEZHË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 910, datë 18.11.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 124 000 000 (njëqind e njëzet e katër milionë) lekë, pa TVSH, për financimin e rindërtimit të konviktit të shkollës së mesme profesionale "Kolin Gjoka", Bashkia Lezhë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore

të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Lezhë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 792, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 151, DATË 10.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË ÇERDHES 'VALIAS', NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR, NË FSHATIN VALIAS, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 151, datë 10.3.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 65 646 444 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të çerdhes në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, dhe 2/1 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 793, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 26, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKITË KAMZË DHE KAVAJË DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, për financimin e rindërtimit/ rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Kamzë, në masën 13 272 319 (trembëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e çerdhes "Kamzë", i cili i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 794 datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.145, DATË 11.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË SHIJAK, KAMZË, KAVAJË DHE KRUJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e Zëvendës-kryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr.145, datë 11.3.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 52 585 299 (pesëdhjetë e dy milionë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Shijak dhe Kamzë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 43 145 299 (dyzet e tre milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 9 440 000 (nëntë milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Shijak dhe Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 795, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 90, DATË 9.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT TË GODINËS KOPSHT/ÇERDHE NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË MIRDITË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 90, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Mirditë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 3 747 393 (tre milionë e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për ndërtimin e godinës kopsht/çerdhe në zonën e re për zhvillim, njësia administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, dhe do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 796, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 89, DATË 9.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË GODINAVE, SPITALI 'SHENJTA MARI' DHE DREJTORIA E SHËNDETIT PUBLIK (ISH-SPITALI INFEKTIV), NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË MIRDITË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 89, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përveç përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi, Bashkisë Mirditë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar, fondi në masën 75 194 683 (shtatëdhjetë e pesë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të godinave, spitali "Shenjta Mari" dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-Spitali Infektiv), Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, që do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr.797, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.935, DATË 25.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) DHE BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË DURRËS DHE LEZHË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit

dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4/1, të vendimit nr.935, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 4/2, me këtë përmbajtje:

"4/2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Durrës, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, është në masën 261 381 097 (dyqind e gjashtëdhjetë e një milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 798, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.68, DATË 3.2.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË BIBLIOTEKËS 'GJERGJ FISHTA' DHE CAKTIMIN E BASHKISË LEZHË SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr.68, datë 3.2.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 93 600 000 (nëntëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë, pa TVSH, për financimin e riforcimit dhe të rikonstruksionit të bibliotekës "Gjergj Fishta", Bashkia Lezhë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Lezhë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr.800, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.749, DATË 9.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË GODINËS SË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT DHE CAKTIMIN E INSTITUTIT TË NDËRTIMIT SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", me propozimin e

Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr.749, datë 9.12.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2022, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin buxhetor "Planifikim, menaxhim dhe administrim" 01110, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm" shtohet fondi prej 55 144 331 (pesëdhjetë e pesë milionë e njëqind e dyzet e katër mijë e treqind e tridhjetë e një) lekësh pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Ndërtimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 801, datë 12.12.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, SI DHE ÇDO NDËRHYRJE TJETËR NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE BANESAVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2.3, të vendimit nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shifra dhe fjalët "... 476 247 021 (katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëzet e një) ..." zëvendësohen me "... 335 075 900 (treqind e tridhjetë e pesë milionë e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind) ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 802, datë 12.12.2022

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 3.2, shifra, "... 605 498 838 (gjashtëqind e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë) lekë ..." zëvendësohet me shifrën "... 1 265 498 838 (një miliard e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë) lekë ...";

b) Pas pikës 3.2 shtohet pika 3.3, me këtë përmbajtje:

"3.3 Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 387 370 974 (treqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e treqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit dhe ndërtimit të infrastrukturës publike, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 803, datë 12.12.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 441, DATË 3.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E HARTIMIT TË PROJEKTEVE PËR MIRATIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT PËR NDËRTIMIN E NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË ZONAT E SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR, NË BASHKITË DURRËS, KAVAJË, KAMZË, MIRDITË, KRUJË, KURBIN, LEZHË, SHIJAK DHE VORË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 441, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shifra dhe fjalët "... 254 159 368 (dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH" zëvendësohen me "...165 743 507 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e shtatëqind e dyzet e tre mijë e pesëqind e shtatë) lekë pa TVSH ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 804, datë 12.12.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 587, DATË 22.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT E SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjes "i", të shkronjës "b", të nenit 13, dhe të nenit 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

"Në pikat 4 dhe 4.1, shifra dhe fjalët "... 3 671 841 924 (tre miliardë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një milionë e tetëqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH ..." zëvendësohen me "... 6 241 428 906 (gjashtë miliardë e dyqind e dyzet e një milionë e katërqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e gjashtë) lekë pa TVSH ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 806, datë 12.12.2022

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË MAT TË PRONËS NR. 717, ME EMËRTIM "SHTËPIA E USHTARAKËVE", ME VENDNDODHJE NË BURREL, ZONA KADASTRALE 1326, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR, DHE VENDIMIN NR. 771, DATË 14.11.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BURREL, TË QARKUT TË DIBRËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 dhe 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Mat të pronës nr. 717, me emërtim "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje Burrel, zona kadastrale nr. 1326, sipas plan-rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për realizimin e funksioneve administrative dhe shërbimeve në interes të komunitetit vendës dhe kryerjen e funksioneve të tjera sipas ligjit.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, hiqet prona nr. 717, me emërtim

"Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje Burrel, zona kadastrale nr. 1326, sipas plan-rilevimit, dhe shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 771, datë 14.11.2007, të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë Mat i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, tjetërsimi dhe dhënia në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Mat dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



VENDIM
Nr. 808, datë 12.12.2022

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË PRONËS ME EMËRTIM "AGJENCIA LUNDËR", ME VENDNDODHJE NË LUNDËR, TIRANË, ZONA KADASTRALE 2529, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës me emërtim "Agjencia Lundër", me vendndodhje në Lundër, Tiranë, zona kadastrale 2529, sipas plan-rilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ngritjen e një kompleksi argëtimi dhe sportiv.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit)", të ndryshuar, hiqet prona me emërtim "Agjencia Lundër", me vendndodhje në Lundër, Tiranë, zona kadastrale 2529, sipas plan-rilevimit që i bashkëlidhet vendimit.

3. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, si dhe tjetërsimi i pronës.

4. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, përpara marrjes në dorëzim të pronës, të lidhë aktmarrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Ministrinë e Drejtësisë (Arkivin Shtetëror të Ministrisë së Drejtësisë), për plotësimin e nevojave të tyre, sipas projektit të paraqitur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe dakordësuar midis palëve respektive, për të garantuar vazhdueshmërinë e funksionalitetit të këtyre institucioneve.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE
Prona "Rezervat Matriale të Shtetit Agjencia Lundër", Farkë, Tiranë

PRONARI SHTET, MM, (Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Matriale të Shtetit) DATË 04/11/2022 QËLLIMI: Për ndryshimin e Përgjegjësisë së Administrimit nga DPRMSH te FSHZH

VENDNDODHJA
Bashkia Tiranë ZVASHK Tiranë Nr.Pasurisë 867 Z.K 2529 Indeksi i Hartës K-34-100-(44-B, 44-D)
TE DHËNAT E PASURISË
Lloji i pasurisë Sip e pasurisë 95 320 m² Sip. e gjurmës së ndërtimit 10 884m² Nr. kateve Nr. pemeve

Nord =4571974.77 East = 488408.83 — KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH) — Nord =4571974.77 East = 489100.05



SHPJEGUESE:

Kufiri sipas faktit
Sip. S1= 94 820m²
Sip S2 = 2 930m²
Sip.S3 = 1 650m

Brenda S1 ndodhen sipëfaqet e transferuara me vkm, përkatësisht:
Depo nr.5 transferuar me vkm tek Ministria e Drejtësisë, Sip.= 960 m²
Depo nr.4 transferuar me vkm tek KQZ, Sip.= 960m²
Depo nr.2 transferuar me vkm tek KQZ, Sip.= 960 m²
Sipërfaqja A transferuar me vkm tek KQZ, Sip.= 765 m²
Sipërfaqja B transferuar me vkm tek KQZ, Sip.= 435 m²
Sip. e përgj. e transferuar = 4080 m²
Sip. S1 pas transferimit mbetet = 90740 m²
Sip. e përgj. S1+S2+S3 që i mbetet RMSH agjencia Lundër = 95 320 m²

Nord =4571342.11 East = 488408.83 — SH 1: 2500 — Nord =4571342.11 East = 489100.05

NR	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	NIPT/IGJIU
1	Veri			590/1/8, 857/1/26, 27,28	K51726024H
2	Lindje			765	
3	Jug				
4	Perëndim			867/10,590/1/8,1/8	

REALIZOI PËR IGJIU
Major Rudina Gjogu
KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI MArch. Teuta **KANXHERI**

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti
DVASHK
Nënshkrimi
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori
Nënshkrimi/ Vula

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Ortofoto 2018
PËRCAKTIMI I KUFIRIT Sipas dokumentacionit hartografik arkivor marrë në DPRMSH Agjencia Rajonale Tiranë.
Shënime : Ky planrilevim u hartua në zbatim të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Matriale të Shtetit nr.380/3, datë 12.04.2022 bazuar në dokumentacionin hartografik arkivor, orto foto të vitit 2018 e çertifikuar nga ASIG.

PRONARI: SHTET MM, (Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Matriale të Shtetit)
MIRATOHET
NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTORI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
Sokol **ZAIMI**

VENDIM
Nr. 809, datë 12.12.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 23.4.2011, "Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve", dhe të nenit 12, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 9, e vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Përjashtimisht, për vitin 2022, fondi i veçantë i institucioneve qendrore buxhetore dhe jobuxhetore, institucioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore, njësive të fondeve speciale, institucioneve publike të krijuara me ligj të posaçëm, ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare me kapital mbi 50% shtetëror në varësi të institucioneve qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, nuk përdoret për veprimtari social-kulturore dhe shpërblimin e punonjësve.".

2. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 810, datë 12.12.2022

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 646, DATË 22.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE E TË KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES SË ZHVILLUESIT NË ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, "Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe të zhvillimit ekonomik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 646, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 4 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

"4. Procedurë jokonkurruese për përcaktimin e zhvilluesit në rastet e investitorëve me status "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar / veçantë", sipas përcaktimeve në shkronjën "d", të pikës 3, të nenit 8, sipas së cilës specifikohen dy nënsektorët përbërës të sektorit "zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik", të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike.".

Neni 2

Pas nenit 14/1 shtohet neni 14/2, me këtë përmbajtje:

"Neni 14/2

Procedurë jokonkurruese për përcaktimin e zhvilluesit në rastet e investitorëve me status "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/veçantë.".

Përcaktimi i zhvilluesit bëhet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e institucionit përgjegjës, sipas procedurës së mëposhtme:

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve përcjell pranë institucionit përgjegjës vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga subjekti investuese, për realizimin e projektit/ investimit strategjik, zonë e teknologjisë dhe të zhvillimit ekonomik.

2. Institucioni përgjegjës, pasi ka marrë informacionin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën", për statusin aktual të pasurisë, për sipërfaqen në të cilën do të ndërtohet zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, të shoqëruar me aktin përkatës të pronësisë, në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, i propozon Këshillit të Ministrave shpalljen e zonës dhe zhvilluesin e saj.

3. Me shpalljen e zonës, sipas pikës 2, ndërtimet pa leje nuk legalizohen, por trajtohen nga shteti nëpërmjet shpërblimit financiar, programeve financiare të strehimit ose formave të tjera alternative të trajtimit.".

Neni 3

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 16/1
Anulimi i një procedure konkurruese

1. Institucioni përgjegjës me urdhër të ministrit anulon procedurën e konkurrimit, në rastet kur:

a) në procedurat konkurruese nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;

b) konstaton se dokumentet e konkurrimit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme që pengojnë vijimin e procedurës;

c) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive nuk mund të zhvillohet procedura konkurruese.

2. Institucioni përgjegjës nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë, në bazë të pikës 1, të këtij neni.

3. Institucioni përgjegjës u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e konkurrimit menjëherë, por jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e vendimit.

4. Institucioni përgjegjës publikon vendimin e anulimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, vetëm pas kalimit të afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të nenit 15/1, të këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 813, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 606, DATË 14.9.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR PËR AKTIVITETET JASHTË ORARIT MËSIMOR DHE PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, të shkronjës "b" të pikës 3, të nenit 54, të ligjit nr. 69/2012, "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 6, të vendimit nr. 606, datë 14.9.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

"6/1. Përjashtimisht, për vitin 2022, procedurat e prokurimit për blerjen e bazës materiale didaktike dhe infrastrukturës mbështetëse, sipas kurrikulave të hartuara për secilën tematikë të programit kombëtar për aktivitetet jashtë orarit mësimor, realizohen nga zyrat vendore të arsimit parauniversitar.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM
Nr. 21, datë 9.12.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 11.2.2022, "PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë"; të pikës 3, të nenit 6 dhe të nenit 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të pikës 5, të VKM-së nr. 101, datë 9.2.2022, "Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2022", ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 1, datë 11.2.2022, "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural", të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në kreun VII, "Procedurat që do të ndiqet për përzgjedhjen, verifikimin dhe pagesat për masat mbështetëse me nr. 1, 3–7/1", bëhen shtesat si vijon:

a) Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me ketë përmbajtje:

"Për masën 7/1, të gjithë aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e pronësisë së tokës ose përdorimit të saj, brenda datës 16.12.2022.".

b) Pas pikës 12, shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

"Për verifikimet në terren të numrit faktik të tufës bazë dhe zgjojeve, për masat mbështetëse nr. 6 dhe 7, angazhohen edhe veterinerët zyrtarë të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.".

2. Në kreun X, "Kriteret, dokumentacioni dhe procedura për masën 13: mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi", në pikën 7 bëhet ndryshimi, si vijon:

"Togfjalëshi '15 dhjetor 2022' zëvendësohet me togfjalëshin '31 dhjetor 2022"'.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 166
Datë: 2022/12/14 15:58:42
3d08e168-2948-44f0-aa87-3602dd5dba8d

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë